



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Tiranë më 28 .06.2024

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
QERSHOR 2024

1.	04.06.2024	Kërkojmë të informohemi dhe të na vihet në dispozicion të dhënat zyrtare për: - Të dhëna statistikore për ndotjen e ajrit: të ndara sipas vendndodhjes, lloji i	10.06.2024	Lidhur me informacionin e kërkuar për monitorimin e cilësisë së ajrit urban tabela më poshtë për vendndodhjen e stacioneve dhe parametrat që maten .	Përfunduar	Nukka										
				<table border="1"><thead><tr><th>Nr</th><th>Stacionet</th><th>Vendndodhja</th><th>Treguesit</th><th>Kordinatat</th></tr></thead><tbody><tr><td>1</td><td>Tirana Mobile</td><td>Sauk,Tiranë</td><td>PM10,NO2, SO2 , O3, CO dhe BTEX</td><td>41°19'49.94"N 19° 48'42.55"E</td></tr></tbody></table>	Nr	Stacionet	Vendndodhja	Treguesit	Kordinatat	1	Tirana Mobile	Sauk,Tiranë	PM10,NO2, SO2 , O3, CO dhe BTEX	41°19'49.94"N 19° 48'42.55"E		
Nr	Stacionet	Vendndodhja	Treguesit	Kordinatat												
1	Tirana Mobile	Sauk,Tiranë	PM10,NO2, SO2 , O3, CO dhe BTEX	41°19'49.94"N 19° 48'42.55"E												

ndotësve, mesatarja ditore për periudhën Janar- Dhjetor 2023.	2	Tirana Higjena	Instituti Higjenës	i	PM10,NO2, SO2 , O3, CO dhe BTEX	41o32'20.00"N 19o82'66.70"E
	3	Tirana MTM	Ministria Turizmit dhe Mjedisit	e	PM10,PM2.5	41o32'74.20"N 19o81'80.20"E
	4	Tirana AKM	Agjencia Kombetare e Mjedisit	e	PM10,PM2.5	41o31'51.70"N 19o81'55.30"E
	5	Durrës	Oborri shkolles "Jusuf Puka"	i	PM10/PM2.5, SO2 , NO2 , O3, CO, BTEX	41°18'50.26"N 19° 26'57.44"E
	6	Shkodër	Oborri qendres Shëndetësore të Reabilitimit të handikapateve mendore.	i	PM10/PM2.5, SO2 , NO2 , O3, CO, BTEX	42°04'25.13"N 19°31'24.62"E
	7	Elbasan	Përpara godinës së qarkut Elbasan	së	PM10, SO2 , NO2 , O3, CO, BTEX	41°06'39.53"N 20°04'53.96"E
	8	Korçë	Oborri shkollës "Raqi Qirinxhi".	i	PM10/PM2.5, SO2 , NO2 , O3, CO, BTEX	40°37'33.39"N 20° 46'48.76"E
	9	Fier	Oborri shkollës "Janaq Kilica"	i	PM10/PM2.5, SO2 , NO2 , O3, CO, BTEX	40°72'53.70"N 19° 55'50.50"E

2.	05.06.2024	<p>Në funksion të shqyrtimit të një rasti që lidhet me çështjet e menaxhimit të mbetjeve, kam nevojë për të dhëna sa vijon:</p> <p>1. A kryen AKM inspektime në subjekte për çështje të menaxhimit të nënprodukte -ve shtazore jo për konsum human?</p> <p>2. Nëse po, lutemi dhe kërkojmë të dhëna statistikore për numrin e kontrolleve në subjekte me objekt menaxhimin e nënprodukte -ve shtazore</p>	06.06.2024	<p>Në mbështetje të legjislacionit në fuqi dhe në zbatim të Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, VKM, Nr. 568, datë 17.07.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, Ligjit Nr. 52/2020, për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” të ndryshuar sqarojmë se në shtojcën Nr.1 të Ligjit Nr. 52/2020 për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” të ndryshuar, subjektet që ushtrojnë aktivitet në menaxhim e nënprodukteve shtazore, janë objekt inspektimi nga Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.</p> <p>Referuar sistemit online të "e-inspektimi" AKM në nivel qendror dhe rajonal ka ushtruar kontrolle në subjektet që ushtrojnë aktivitet në menaxhim të nënprodukteve shtazore jo për konsum human, në subjektet si me poshte vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. "I.N.C.A" – ne total 8 inspektime dhe 0 mase administrative 2. "BALCAN ZOO FARM 2014" – ne total 6 inspektime dhe 0 mase administrative 	Përfunduar	Nuk ka
----	------------	---	------------	--	------------	--------

		<p>jo për konsum human, si dhe numrin e rasteve të konstatuara me shkelje Shtroj këtë pyetje për paqartësitë lidhur me klauzolën sipas neni 4/e të ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 'Për menaxhimin e integruar të mbetjeve' sipas të cilës Përfshihen nga objekti i këtij ligji fushat e mëposhtme, të cilat rregullohen me legjislacion të veçantë: e) ujërat, nënproduktet e mbetjet, në</p>				
--	--	---	--	--	--	--

		<p>rastet kur trajtohen nga ligje të tjera si: i) ujërat e përdorura; ii) nënproduktet shtazore dhe produktet e përpunuara, përveç atyre që destinohen për incinerim, për në lëndfill ose për përdorim në një impiant kompostimi ose biogazi;</p>				
3.	06.06.2024	<p>Më konkretisht kërkoj, 1. Listën e subjekteve (përfshirë, emrin, adresën e saktë të vendndodhjes (pra, jo vetëm qytetin),</p>	10.06.2024	<p>Në lidhje me kërkesën për informacion lidhur me miratimin e lejeve mjedisore dhe VNM-ve, për subjektet ekonomike të cilat aplikuan në sistemin elektronik të QKB, Ju informojmë si më poshtë vijon:</p> <p>Aplikimet e operatorëve për pajisjen me Leje Mjedisi dhe Licence III.2.B bëhen në mbështetje të Ligjit 10081/2009 "Për autorizimet, lejet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë". Aplikimet bëhen nëpërmjet portalit qeveritar "e-albania".</p> <p>Operatorët e pajisur me Leje mjedisi Kategoria III.1 për ndikimin në mjedis dhe licencë nënkategorisë III.2.B janë të publikuara në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Lejeve dhe Autorizimeve të lëshuara nëpërmjet Qendrës Kombëtare të</p>	Përfunduar	Nukka

	<p>aktivitetin e propozuar, lloji i lejes) të cilat u klasifikuan si të përshtatshme për tu pajisur me leje mjedisore, prej 1 Janar 2023 e deri 31 Maj (2024)</p> <p>1.1 Listën e subjekteve (përfshirë, emrin, adresën e saktë të vendndodhjes (pra, jo vetëm qytetin), aktivitetin e propozuar, lloji i lejes) të cilat nuk u pajisën me leje mjedisore (pra, ndonëse aplikuan), prej 1 Janar</p>		<p>Biznesit. Ju orientojmë se operatorët kalojnë aplikimet nëpërmjet QKB-së.</p> <p>Në linkun e mëposhtëm mund të verifikoni Lejet e Mjedisit kategoria III.1 për ndikimin në mjedis si dhe licencat e nënkategorisë III.2.B:</p> <p>https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/</p> <p>Regjistri Kombëtar i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, ka për qëllim të sigurojë aksesin e lirë të publikut në përputhje me ligjin.</p> <p>Duke qenë se aplikimet e operatorëve për tu pajisur me Leje dhe Licenca kalojnë nëpërmjet QKB-së, të gjitha aplikimet me vendimet përkatëse janë të publikuara në Regjistrin Aplikativ pranë QKB-së.</p> <p>Në linkun e mëposhtëm mund të verifikoni aplikimet për Lejet e Mjedisit kategoria III.1 për ndikimin në mjedis si dhe licencat e nënkategorisë III.2.B:</p> <p>https://qkb.gov.al/informacion-mbi-procedur%C3%ABn/regjistri-i-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/regjistri-aplikativ/</p> <p>Në bazë të Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, dhe VKM-së Nr. 828, datë 28.12.2023, "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", të ndryshuar, porta hyrëse e aplikimit dhe porta publikuese e vendimeve në sistemin e "e_lejeve" është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Gjithashtu vendimet për VNM Paraprake/Thelluar janë të publikuara ne web-in e</p>		
--	--	--	---	--	--

		<p>2023 e deri 31 Maj (2024).</p> <p>2. Listën e subjekteve (emri i subjektit zhvillues, vendi i saktë ku do të zhvillohet projekti, lloji i projektit etj.) të cilat u klasifikuan për VNM paraprake, VNM të thelluar, prej 1 Janarit 2023 e deri në 31 Maj 2024.</p> <p>2.1 Listën e subjekteve të cilat nuk u klasifikuan për VNM paraprake, VNM të thelluar, pra, atyre të cilave iu refuzua</p>		<p>Agjencisë Kombëtare të Mjedisit : www.akm.gov.al/vendime-vnm.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

		(ndonëse aplikuan), prej 1 Janarit 2023 e deri në 31 Maj 2024.				
4.	07.06.2024	Në lidhje me aplikimin e subjektit “Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare” në lidhje me procedurën për njoftim të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin “Hidrocentrali i Skavicës”, me vendodhje në luginën e Drinit të Zi. Subjektit e cila është refuzuar automatikisht nga sistemi i e_lejeve, pas	10.06.2024	Agjencia Kombëtare e Mjedisit mori në shqyrtim aplikimin e subjektit “Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare” sh.a, në lidhje me procedurën për njoftim të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin “Hidrocentrali i Skavicës”, me vendodhje në luginën e Drinit të Zi. Subjektit është refuzuar automatikisht nga sistemi i e_lejeve, pas tejkimit të afatit ligjor. Subjekti Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a nuk ka riaplikuar për kryerjen e procedurës së VNM-së së Thelluar.	Përfunduar	Nuk ka

		<p>tejkalimit të afatit ligjor, desha te di nese:</p> <p>1. Nëse subjekti Koorporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a ka riaplikuar për kryerjen e procedurës së VNM-së së Thelluar.</p> <p>2. Nese po, mund te me nisni dokumentat perkatese te aplikimit</p>				
5.	06.06.2024	<p>Dua të raportoj për një problem të madh me ndotjen në qytetin e Delvinës . Ka reth 3 muaj që pusi gazit digjet dhe i gjithë squfurin e tij e thithin</p>	19.06.2024	<p>Bazuar në ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administrates Shtetërore”, VKM-së Nr.867/2014 “Për procedurën e bashkëpunimit në institucionet e Administratës shtetërore” dhe VKM-në Nr.568/2019 “për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKM”, Ligjin Nr.,10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, ligjit nr.10448/2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ligjin nr.10433/2011 “Për inspektimin në RSH”.</p> <p>Referuar programit të punës Nr.1571 prot datë 10.06.2024 lidhur me ankesën e ardhur në ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë për trajtim dërguar nga AKM në rrugë elektronike, gurpi i punës bëri verifikimin si më poshtë:</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>qytetarët e Delvinës .. Ju lutem shikojeni pak këtë sepse është vërtet problem serioz për shëndetin dhe kërcënues për jetën tonë dhe nuk kemi ku të ankohe mi.</p>		<p>U konstatua se ushtron aktivitet operatori Delvina Gas Company. Operatori kryen aktivitet kërkimin e naftës dhe gazit natyror me I.D. 1.6 “Nxjerrja e naftës dhe gazit natyror” me vendondodhje vendburimi i Gazit, Delvinë.</p> <p>Nga komunikimi dhe verifikimi i dokumentacionit rezulton se shoqëria “Delvina Gas Company” degë e shoqërisë së huaj, mbështetur në Licencë Marrëveshjen dhe Marrëveshjen Hidrokarbure, ka kryer operacione hidrokarbure me vendburimin e Gazit Delvinë, me qëllim rivendosjen e puseve egzistuese në prodhim. Si rezultat i këtyre operacioneve, që janë shoqëruar me disa problematika të cilat kanë krijuar në kohë të operacioneve të programuara është arritur që pusi Del-12 të vihet në gjendje pune.</p> <p>Si praktikë ndërkombëtare e njohur për industrinë e naftës, kur një pus bëhet gati për prodhim hidrokarburesh, ai kalon një periudhë testimi dhe gjatë kësaj kohe gazi digjet në mënyrë që të mos clirohet në atmosferë (me qëllim minimizimin e ndotjes), ndërsa nafirta bruto grumbullohet.</p> <p>Rezultatet e para gjatë periudhës së testimit janë shumë të rëndësishme për një vendburim pasi ato ndihmojnë në përcaktimin e parametrave të rezervuarit dhe më e rëndësishmja në parashikimin e një profile prodhimi në kohë të vendburimit. Për këtë arsye fazës së testimit i kushtohet kujdes dhe rëndësi e madhe. Zakonisht periudha e testimit ndahet në disa faza : testimi afat-shkurtër, afat-mesëm dhe testimi afat-gjatë, kohëzgjatja e të cilave varet nga karakteristikat e cdo vendburimi në vecanti. Në vendburime të cilat karakterizohen nga parametra të lartë poroziteti, përshkueshmerisë dhe një një strukturë homogjene në drejtim të shpërndarjes së këtyre parametrave. Këto periudha janë zakonisht më të shkurtra se në ato vendburime ku këto parametra janë të ulët dhe struktura është heterogjene, me ndryshim të parametrave në pjesë të ndryshme të saj. Ky është rasti i vendburimit të GAZit Delvinë dhe në këtë rast kohëzgjatja e periudhave të ndryshme të testimit është me e gjatë.</p> <p>Gjatë disa periudhave të ndryshme, që nga fillimi i vitit 2022, pusi Del-12 është vënë në testim disa herë për periudha afatshkurtra, që kanë zgjatur nga 3-15 ditë. Pas vlerësimit të</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>rezultateve është vendosur që pusi të kalojë në një fazë testimi afat-mesme, për një periudhë kohë rreth 90-120 ditë dhe pusi ka qënë në prodhim që nga data 06.03.2024 me disa periudha ndërprerje. Për këtë është përgatitur një Program une dhe janë njoftuar Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe shoqëria “Albpetrol” sh.a.</p> <p>Gjatë gjithë këtyre periudhave të testimit të këtyre 2 viteve të fundit por edhe më parë, kur ka pastur raste të djegies së gazit për arsye të ndryshme, nuk janë krijuar problematika kjo për shkak se gazi i vendburimit të Delvinës është gaz mjaft i pastër, me përmbajtje të metanit prej më shumë se 90 % dhe pot ë marrim komponentët e lehtë C1-C3, kjo përqindje shkon në rreth 98%, gjë që bën që gazi të digjet pa mbetje.</p> <p>Në afërsi të posit dhe pajisjeve të trajtimit të gazit ka një personel të kompanisë prej më shume se 35-40 punonjësish, që ndodhen në afërsi të vendit të djegies së gaqzit duke punuar me turne 12 orëshe. Këta punonjës janë të gjithë të pajisur gjithë kohën me monitore gazi, të cilët janë të regjistruar dhe japin alarm nëse sasia e lëndëve të dëmshme kalon mbi normativën. Pavarësisht kohës relativisht të gjatë të operacinit të gjatë të operacinit të testimit, nuk ka pasur asnjë rast alarmi dhe nuk kanë paraqitur ndonjë shqetësim. Brenda një periudhe të shkurtër kohe, testimi i posit do të përfundojë.</p> <p>Operatori ka kryer dokumentacionin mjedisor me laborator të licensuar dhe akredituar Eko-Studio Projeckt, sipas kushteve të lejes mjedisore që disponon. Dokumentacioni mjedisor, raporti i vetmonitorimit, raporti përmbledhës vjetor i mjeidist, është dorëzuar në AKM Tiranë me Nr.4334 Prot datë 19.04.2024 dhe operimi është brenda kushteve të lejes mjedisore.</p>		
6.	19.06.2024	1.A është dhënë nga Ministria e Mjedisit leja përkatëse për ndërtimin e Termocentra -lit në	26.06.2024	Referuar informacionit te ardhur nga ARM Fier theksohet se dëgjesa me publikun bazuar në Ligjin Nr.10431 datë 09.06.2011 " Për mbrojtjen e Mjedisit,i ndryshuar, Ligjin Nr.10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e Mjedisit , i ndryshuar, Ligjit 10440 datë 07.07.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar është deleguar nga titullallari i institucionit Arm / Fier/ Vlorë / Gjirokastër specialistëve të lejeve të Mjedisit dhe VNM-ve me Nr.2087 Prot, datë04.07.2023, pasi ka mbushur afatin e publikimit sipas	Përfunduar	Nuk ka

		<p>fshatin SUK1 në Roskovec, kërkuar nga “ FIER THERMOELECTRIC“ SHA?</p> <p>2. Nëse nuk ka ende një leje, në cilën fazë është shqyrtimi i kësaj kërkesë?</p> <p>3. A plotësohen të gjitha kriteret ligjore në mbrojtje të mjedisit për këtë projekt?</p> <p>4. Banorët e zonës thonë se nuk janë konsultuar në asnjë rast për këtë projekt? A do të merret parasysh nga ju shkelja e ligjit për konsultimet me banorët?</p>		<p>legjislacionit në faqen WEB të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit Tiranë.</p> <p>Nga specialistët e lejeve të Mjedisit dhe VNM-ve të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/ Vlorë / Gjirokastrë date 05.07.2024 , janë përgatitur njoftimet zyrtare në mbështetje të VKM-Nr.247 datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe për përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore, i ndryshuar , VKM-së Nr.568, datë 17.07.2019 pasi është komunikuar nëpërmjet e-mailit zyrtar me Zhvilluesin / Studion Ekspertët e akredituar për zhvillimin e dëgjësës me publikun, në një afat sa më të përshtatshëm lidhur me kohën. Njoftimet janë drejtuar Bashkisë Roskovec, Organizatave , Ministrisë së Energjitikës, Faqes WEB Zyrtar dhe stendës përkatëse të institucionit.</p> <p>Në datën 19.07.2023 është mbajtur dëgjesa me publikun në vendin, datën dhe orën e caktuar. Takimi është zhvilluar me adresë, Bar Restorant Veliu, Lagja Nr.1, Rruga Bushi Kola, Roskovec, Bashkia Roskovec, Qarku Fier. Më datën 03.08.2023 është dorëzuar në protokollin e institucionit Arm/ Fier/ Vlorë/ Gjirokastrë.</p> <p>Më datë 03.08.2023 ARM ka sjellë pranë AKM-s Proces-Verbalin e dëgjësës me publikut, mbi mbarëvajtjen e këtij procesi, duke shënuar emrat e pjesëmarrësve, minutat e takimit të shoqëruara me foto, problemet e ngritura nga të pranishmit dhe konkluzionet e arritura gjatë kësaj mbledhje</p> <p>Në Sektorin e Shqyrtimit Teknik të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor Subjekti “FIER THERMOELECTRIC”Sh.p.k, ka aplikuar datë 03.10.2023 me AN031020230006, në sistemin online për procedurën e Thelluar të VNM-së, (Deklaratë Mjedisore), për projektin “Impiant Energjitik me Cikël të Kombinuar” me vendndodhje: Roskovec, Fier.</p> <p>Në zbatim të Ligjit nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në</p>		
--	--	---	--	---	--	--

		<p>5. Pse është i domosdoshë m një projekt i tillë? Duke pasur parasysh që bëhet fjalë për një zonë ku bujqësia është shumë e zhvilluar dhe jetike për komunitetin.</p>	<p>Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri vendosi: Lëshimin e Deklaratës Mjedisore pozitive për zhvilluesin.</p> <p><i>Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur vendimi;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Miratimin Paraprak nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për vazhdim e procedurës me nr. 1427/2, date 05.04.2023 “Për ndërtimin e termocentralit me kapacitet të instaluar 170 MW, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncensionit, me vendndodhje ne Roskovec, Qarku Fier. - Shkresën e OST me nr.6549/1 prot. datë 11.11.2022 Lënda: Opinion paraprak mbi lidhjen e TEC Roskovec CCPP, me rrjetin e Transmetimit, Bashkia Fier. - Në mendimin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Fier, Vlorë, Gjirokastër; - Në mendimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. - Në mendimet e anëtarëve të Komisionit nr.118, datë 13.11.2023, i mbledhur në zbatim të Urdhërin nr.75, datë 07.04.2023, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”. <p>Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kushte që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar. <u>Vendimi i VNM se Thelluar (Deklarata Mjedisore) nuk është leje ndërtimi.</u></p> <p>Nga Sektori i Shqyrtimit Teknik për Veprimtaritë në mjedis ju informojmë se nga verifikimi në regjistrin aplikativ pranë QKB-</p>		
--	--	---	--	--	--

				<p>së subjekti “FIER THERMOELECTRIC“ SHA nuk ka aplikim për Leje Mjedisore.</p> <p>Lidhur me pyetjet e tjera që shtrohen në e-mailin e ardhur elektronikisht ka institucione të tjera që ushtrojnë përgjegjësi dhe marim vendimet në përputhje me Ligjin, Vendimet dhe Urdhëresat përkatëse dhe nuk është kompetencë e jona të përgjigjemi.</p> <p>Bashkëlidhur në e-mail gjeni materialet e Dëgjësës me Publikun.</p>		
7	24.06.2024	Kërkojmë të informohemi dhe të na vihet në dispozicion dokumenti: Raport për Gjendjen e Mjedisit per vitin 2023?	24.06.2024	Në përgjigje të kërkesës për informacion , ju informojmë se Raporti i Gjendjes në Mjedis për vitin 2023 është në fazën e përgatitjes. Pas përfundimit final të përgatitjes, ky Raport do të publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe do të jetë i disponueshëm për publikun.	Përfunduar	Nuk ka

